

# BURIMET MIRËMBAJTËSE TE ENERGJISË

Resurset e energjisë përsëritëse nuk thithen kur shfrytëzohen, ato në fakt riprodukohen ose vetë përsëriten (rinovohen). Shfrytëzimi i energjisë së diellit, erës, biomasës, ujit dhe gjeometrale mban me veten rreziqe më të vogla për ambientit jetësor në krahasim me burime jo përsëritëse (jo rinovuese) të energjisë. Në Maqedoni ne mund të shfrytëzojmë shumë më tepër energji nga ajo që nevojitet nëse në këtë moment i shfrytëzojmë burimet përsëritëse (rinovuese) të energjisë.

Energjia e diellit mund të shfrytëzohet në shumë mënyra të ndryshme. Sikur në shtëpitë tona do të kishte një dritare të madhe, të vendosur në anën jugore, rradionet e diellit përmes asaj dritare do të ndihmonte për ngrohjen e shtëpisë. Po ashtu do të arrihej që më shumë nga energjia e diellit të hyrë në shtëpinë me çka do të kursnim në ngrohjen dhe ndricimin elektrik. Kolektorët diellorë, të vendosur në kulmet e shtëpive mund të ngrohin ujin sanitar, i cili mund të përdoret edhe për të ngrohur. Panelet diellore (PV) krijojnë energji elektrike e cila mund ta mbulojë harxhimin e energjisë elektrike në shtëpi. Nëse panelet vendosen në një sipërfaqe më të madhe, ato mund të kënaqin një hapësirë shumë më të madhe me energji elektrike.

Nga Biomasa ne mund të bëjmë edhe karburant për automjetet. Mund të bëjmë bioetanol nga panxharshqeri dhe misri dhe biodizel nga luledielli.

Energjia gjeotermale përdoret më së shumti për të ngrohur duke e shfrytëzuar ujin nëntokësor, siç shfrytëzohet në banjat natyrore. Ky ujë termal po ashtu mund të shfrytëzohet edhe për ngrohjen e qelqoreve (pjesët qelqore), shtëpive private ose të lidhet me sistemin qendror të ngrohjes. Duke shfrytëzuar pompë, amvisëritë mund të ngrohen drejtpërdrejt nga energjia gjeotermale tokësore, duke i zvogëluar nevojat për karburantet fosile.

Bimët, prodhimet bujqësore, hyzmeti shtëpiak dhe plehrat nga shtëpitë (të cilat së bashku njihen si biomasë) janë burime potenciale të energjisë. Si mbeturina kompostuese, nga hyzmeti dhe materialet e tjera organike si kufomë e shtazëve të vdekura dhe hyzmeti i shtazëve mund të prodhohet biogaz. Biogazi pastaj digjet që të prodhohet energjia elektrike ose energjia e nxehtësisë për ngrohje.

Turbinat e erës gjenerojnë energjinë elektrike. Edhe përveç asaj që Maqedonia nuk i ka shpejtësitë më të mira të erës në krahasim me vendet bregdetare, megjithatë ka rajone në të cilat ky lloj gjeneratori të energjisë mirëmbajtëse mund të shfrytëzohet me sukses.

Centralet e mëdha hidroelektrike ekzistuese kanë shumë probleme (prishin balancën ekologjike, bëjnë prishjen vizuale të ambientit etj.), nga ana tjetër centralet e vogla elektrike kanë ndikim minimal ndaj ambientit jetësor.

Mullinjët me erë mund të shfrytëzohen për ngritjen dhe pompimin e ujit. Ata ndërtohen në liqene ose lumenj dhe po ashtu mund të heqin ujin nëntokësor i cili mund të shfrytëzohet për ujitjen e plantacioneve ose mund të heqin ujin e pijshëm për shtazët shtëpiake ose të përdoret si ujë teknik.